



Nr. \_\_\_\_\_ prot

Tiranë më 03.06.2024

**NJOFTIM PËR BASHKËPUNTORË****“PËRMIRËSIMI I QASJES TË BARABARTË NË SHËRBIMET PUBLIKE ME  
STANDARD TË LARTË PËRMES PROGRAMIT GOVTECH”**

Në kuadër të zbatimit të projektit për “Përmirësimin e aksesit së barabartë në shërbimet publike me standard të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH” ratifikuar me ligjin 45/2023, datë 22.06.2023; Planit të implementimit dhe monitorimit të performancës për laboratorët Smart, me akt miratimin, datë 01.12.2023 dhe Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve për vitin 2024-2025 me nr. 1215/1 Prot., datë 19.02.2024 për komponentin III “Përmirësimi i aftësive digjitale dhe themelore të nxënësve në shkollat e pajisura me SmartLab-e nëpërmjet trajnimit të punonjësve digjitalë, drejtuesve dhe mësuesve të arsimit fillor për përmirësimin e aftësisë së kodimit dhe aftësive digjitale” dhe nënkomponentin IV, “Vlerësimi i zbatimit të SmartLab-eve”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), kërkon të rekrutojë bashkëpunorë të jashtëm.

Kjo thirrje bëhet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar për të siguruar ekspertë në fushën e arsimit dhe të TIK-ut me qëllim vlerësimin e dokumentacionit të hartuar nga institucioni i arsimit të lartë (IAL) në kuadër të përgatitjes së materialeve që do të përdoren për zhvillimin profesional të drejtorëve, punonjësve digjitalë, mësuesve të arsimit fillor, si dhe për matjen e arritjeve të nxënësve në zbatim të projektit GOVTECH. Gjithashtu kjo thirrje synon të rekrutojë vlerësues dhe bashkëpunorë të jashtëm, të cilët do të ndihmojnë në procesin e hartimit të dokumenteve për procesin e vlerësimit dhe do monitorojnë /vlerësojnë cilësinë e shërbimit të trajnimit të ofruar nga IAL.

**a) Detyrat e parashikuara për bashkëpunorët e jashtëm:**

- Vlerësimi i dokumenteve, kornizave, manualeve metodologjike dhe instrumenteve të matjes së njohurisë së nxënësve në lëndën e TIK-ut.
- Vlerësimi i fondit të pyetjeve për instrumentet pre-test dhe pos-test.
- Vlerësimi i moduleve të hartuara nga ofruesi i shërbimit të trajnimeve.
- Vlerësimi i efektivitetit të procesit mësimor përgjatë implementimit të programit mësimor të TIK-ut.
- Përgatitja dhe plotësimi i instrumenteve për vlerësimin e moduleve.
- Përgatitja e raporteve me gjetje, rekomandime për shkollat e vlerësuara.

**b) Kualifikimi i kërkuar për kandidatët në këtë thirrje:**

1. Kandidati duhet të ketë eksperiencë në studime dhe analiza në fushën e arsimit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).
2. Kandidati duhet të ketë eksperiencë në hartimin dhe përgatitjen e materialeve dhe dokumenteve të tilla si module dhe korniza trajnimesh, manuale metodologjike dhe instrumente të matjes së njohurisë së nxënësve në lëndën e TIK.
3. Kandidati duhet të ketë eksperiencë në bashkëpunimin me subjekte të cilat në statutin e tyre kanë përmirësimin e cilësisë së sistemit arsimor.
4. Kandidati duhet të ketë përvojë paraprake në analizën, vlerësimin dhe zhvillimin e programeve mësimore si dhe përgatitjen e materialeve mbështetëse për mësuesit etj.
5. Kandidati duhet të ketë marrë pjesë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar.
6. Preferohen kandidatë me përfshirje afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
7. Preferohen që kandidatë të zotërojnë gjuhën angleze.

**c) Kërkesa të tjera:**

1. Gatishmëri për të udhëtuar në qytete të ndryshme të Shqipërisë.
2. Gatishmëri për punë gjatë fundjavave.
3. Zotërim i aftësive për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë dhe platformave interaktive.
4. Aftësi të mira bashkëpunuese dhe komunikuese.

**d) Realizimi i aplikimit**

Dosja e aplikimit për bashkëpunëtorët e jashtëm për këtë thirrje duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- CV sipas formatit EUROPASS
- Fotokopje e kartës së identifikimit
- Diplomat dhe certifikatat
- Dëshmi të ndryshme kualifikimi

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në rrugë postare pranë ASCAP, në adresën Rruga. "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë, Shqipëri, deri në datë **12.06.2024**.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**  
**Gerti JANAQI**